



PROCESVERBAL I VII 2025

I mbajtur me rastin e mbledhjes së VII (shtatë) për vitin 2025 të Komitetit për Komunitete Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 16.07.2025
Ora : 09:00

Prezentë:

-znj.Melisa Shabanaj Kryesuese

z.Nazim Shabanaj

znj.Aferdita Morina

z.Zek Berisha

z.Aziz Bytyqi

znj.Dorentina Zenelaj

Të pranishëm tjerë:

Xheladin Sadikaj-Zyrtar për Kthim dhe Komunitete

Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore

Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim

Përfaqësues i OSBE-së

Përfaqësues i LMT-së

Avni Bytyqi-para se me marrë fjalën unë kam një propozim,pasi që jem në fazën e fundit të këtij mandati Kryesuesi i Komisionit ka dhënë dorëheqje kisha propozu që ta zgjedhim Kryesuesin e Komunitetit i cili duhet të jetë nga komuniteti pakicë.

Melisa Shabanaj zgjidhet Kryesuese e Komitetit për Komunitete.

Kryesuesja-proponon këtë rend dite

REND DITE

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit për vitin 2024,të komisionit komunal të aksionarëve të NPL “Stacioni i Autobusëve” SH.A;**
3. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për bartjen e THV 2023dhe THV 2024 të pa shpenzuara gjatë vitit fiskal 2024 të barten për shpenzim në vitin fiskal 2025;**
4. **Të ndryshme;**

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Melisa Shabanaj-e hedh në votim

Unanimisht miratohet

Pika 2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit për vitin 2024,të komisionit komunal të aksionarëve të NPL “Stacioni i Autobusëve” SH.A;

Kryesuesja-laboron pikën dhe ja jep fjalën zyrtarit ligjor

Avni Bytyqi-pasi që Komuna është aksionarë 100% këta kan obligim të raportojnë para Kuvendit dhe Komitetit për politik dhe financa dhe para Komiteti për Komunitete për punën dhe aktivitetet që kan bër për vitin 2024.

Kryesuesja-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për bartjen e THV 2023dhe THV 2024 të pa shpenzuara gjatë vitit fiskal 2024 të barten për shpenzim në vitin fiskal 2025;

Kryesuesja-laboron pikën dhe hap debatin;

Avni Bytyqi-Edhe ky është një projekt vendim që ka të bëj me të hyrat vetanake të Komunës që jan realizuar gjatë vitit 2023-2024 por nuk janë shpenzu si pasojë që kan mbet nga projektet e caktuara të investimeve kapitale,sipas zyrtarit kryesor financiar deri në këtë vit Ministria e Financave i ka bartë vet këto mjete dhe këtë vit i ka obligu Komunat që ta bëjnë bartjen me vendim.

Kryesuesja- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika4. Të ndryshme

Kryesuesja-pasi nuk ka debat,mbyllet takimi.